



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 27, datë 5.04.2017

PËR

“MIRATIMIN E KUOTËS DITORE NË QËNDRAT SOCIALE”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” nenin 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, për “Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 29.10.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e menci në Qendrën Sociale “Të qëndrojmë së bashku” si dhe miratimin e një ndryshimi në strukturë”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 4, datë 01.03.2012, për “Krijimin e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, dhe miratimi i strukturës organizative”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 11, datë 05.04.2012 për “Ristrukturimin e Qendrës Sociale Të Qëndrojmë së Bashku, “Qendrës Komunitare Multidisiplinare për Fëmijët dhe Familjet në Nevojë” dhe “Qendrës Komunitare për të Moshuarit”, miratimin e strukturave të tyre organizative si dhe rishpërndarjet në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2012”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 60, datë 24.12.2012, për "Krijimin e Qendrës Komunitare Shkozë dhe miratimin e strukturës së saj organizative si dhe një shtesë në numrin e përgjithshëm të strukturës organizative të Qendrës Sociale "Të qëndrojmë së bashku", Qendrës Sociale Multidisiplinare dhe Qendrës Sociale "Shtëpia e Përbashkët", Udhëzimin nr. 5, datë 1.8.2012, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në qendrat sociale ditore të përkujdesit shoqëror që do të jetë jo më shumë se 160 lekë (njëqind e gjashtëdhjetë lekë).
2. Efektet Financiare të pikës 1 të vendimit do të përballohen nga shpenzimet operative të planifikuara në buxhetet e qendrave sociale per vitin 2017.

3. Pika 2 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, datë 29.10.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e menciës në Qendrën Sociale “Të qëndrojmë së bashku” si dhe miratimin e një ndryshimi në strukturë” (i ndryshuar), shfuqizohet.
- 4 Pika 3 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 04, datë 01.03.2012 për “Krijimin e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, dhe miratimi i strukturës organizative” (i ndryshuar), si dhe pika 6 e VKB-së nr. 11 datë 5.04.2012, shfuqizohen.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, “Qendra Sociale Multidisiplinare”, “Qendra Sociale Shtëpia e Përbashkët” dhe “Qendra Sociale të Qëndrojmë së Bashku” nën administrimin e Bashkisë Tiranë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI